



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/060 – 60100

Më: 19 maj 2025


Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërras mbledhjen e IV/2025 (e katër) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **29 maj 2025 (e enjte)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 24 prill 2025 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të Shoqërisë Civile;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovicë;
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;



Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Br. 001/060 – 60100

Dana: 19 maja 2025



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Na osnovu člana 43 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 30 stav 1 i člana 35 stav 2, Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15. oktobra 2008. godine sazivam IV/2025 (četvrtu) redovnu sednicu Skupštine opštine Prizren, koja će se održati **29 maja 2025 (četvrtak)**, u sali za sastanke Skupštine opštine Prizren, u "Beloj Kući", sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da u svojstvu odbornika Skupštine opštine učestvujete u radu ove sednice pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ove sednice predlažem sljedeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika od: 24 aprila 2025 (redovna);
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Pitanja odbornika i odgovori;
4. Razmatranje i usvajanje prethodne predlog-odluke o davanju opštinske imovine na kratkoročno korišćenje organizacijama civilnog društva;
5. Razmatranje i usvajanje predloga odluke o formiranju Komisije za procenjivanje;
6. Razmatranje i usvajanje Projekt-Pravilnika za sahranjivanje i održavanje novog groblja u Prizrenu u Landovici;
7. Finansijski izveštaj za period januar-mart 2025. godine.



Predsedavajuća Skupštine
Antigona Bytyqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ

No. 001/060 – 60100

Tarih: 19 Mayıs 2025

P r i z r e n



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Yerel Özyönetimi Yasasının 43.maddesi, Belediye Meclis toplantılarının düzenlenmesi için 02/2015 sayılı (YYB) İdari Yönergenin 3. Maddesi, 1. Fıkrası, 1.2. noktası, 5. Maddesi ve 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35.maddesi, 2.fıkrası gereğince **29 Mayıs 2025** tarihinde (Perşembe günü)) saat **10.00'dan** başlayarak "Beyaz Evde" Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin **IV. / 2025 (Dördüncü)** düzenli oturumunu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmaları için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz.

İşbu Oturum Çalışması için aşağıdaki:

GÜNDEMİ

öneriyorum

1. 24 Nisan 2025 tarihindeki (olağan oturum) oturum tutanağın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
2. Gündemin görüşülmesi ve kabul edilmesi;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların ortaya atılması;
4. Belediye taşınmazlarının Sivil Toplum Örgütlerine kısa süreli kullanımına ilişkin ön teklif- öneri kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
5. Değerlendirme Komisyonunun kurulmasına ilişkin öneri kararın görüşülmesi ve kabul edilmesi;
6. Prizren'in Landovica'daki yeni mezarlığın defin ve bakımına ilişkin yönetmelik taslağının görüşülmesi ve kabul edilmesi;
7. Ocak-Mart 2025 dönemi Maliye Raporu.

Meclis Başkanı
Antigona Bytyqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja III / 2025 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 24 prill 2025, filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 29 anëtarë të Kuvendit të Komunës, u bashkëngjitën edhe anëtarë të tjerë.

Të pranishëm në mbledhje ishin, Kryetari, Nënkryetari dhe Drejtorët Komunal.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e mediumeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar drejtor, i nderuar zëvendës kryesues, përshëndetje për të gjithë. Për sot siç jeni të njoftuar e kemi thirrur mbledhjen e radhës pra mbledhjen e tretë për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Të pranishëm jemi 29 anëtarë të Kuvendit ku konstatoj se kemi kuorum për me i vazhduar punimet e kësaj seance. Dhe për sot e kemi këtë rend dite të rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Rendi i ditës është ky:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 27 mars 2025 (e rregullt),
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane;
6. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 27 mars 2025 (e rregullt)

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po fillojmë me pikën e parë sa i përket procesverbaleve. A keni diçka, ndonjë vërejtje, sugjerim, diçka? Në qoftë se jo, po e hedhim në votim. Prezent jemi 29 anëtarë. Kush është për, që të miratohen procesverbalet? Unanimisht. Ju falenderoj të gjithëve.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush diçka me shtu rreth rendit të ditës? Në qoftë se jo, atëherë po e hedhim në votim edhe rendin e ditës. Prezent jemi 29 anëtarë. Kush është për që të miratohet rendi i ditës? Unanimisht. Ju faleminderit të gjithëve.

3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem kush e kërkon fjalën ta ngritni dorën. Po Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendar. Meqë po mungon kryetari, nënkryetari. Megjithatë po e parashtroj si pyetje. Projekti buxhetimi me pjesëmarrje, paratë tona, idetë tona, Prizreni ynë, qysh është cek aty, që ka vazhduar edhe në këtë vit, cila është arsyeja e mos implementimit apo së paku fillimit të punimeve të projekteve të vitit të kaluar? Njëri nga këto projekte ka qenë edhe renovimi i shkollës së vjetër në Gjonaj, që s'ka filluar fare puna. Pyetje për drejtoreshën e emergjencave. Çfarë po ndodh me projekin e kamerave të qytetit. Janë parë pak kamera të vendosura diku në qytet. Pse nuk po vazhdon vendosja e atyre në pjesë të tjera dhe a keni verifikuar a janë në përputhje specifikat e kamerave të vendosura me ofertën tenderuese, kur dihet se mund të kemi format të njëjtë të një produkti, por specifikat dhe kualiteti i kamerës dallon dukshëm. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Bajram, dikush tjetër? Po, Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Meqënëse unë pyetjet kryesisht i kam për kryetarin edhe drejtorin e shërbimeve publike, por të dy në këtë rast nuk janë. Pavarësisht deklarimeve të mia edhe në seancën e kalume, drejtori Lamaj as që e mori mundin të përgjigjet, pavarësisht që nuk isha këtu, por që në momentin kur jepen pyetjet, ai obligohet që të përgjigjet. Unë prita ndoshta do të më përgjigjet me shkrim, po as këtë nuk e bëri. Pra, kjo qeverisje veç po kalon në arrogancën edhe më të thellë të saj. Unë sot do ta ngrej një çështje të një qytetari, i cili qytetar është 92 vjeçar, me emrin Alush Krusha, i cili me dhjetëra herë ka tentuar që të takohet me kryetarin e komunës, por për çudi ju që deklaroheni se jeni të hapur me qytetarë, plakun në moshën 92-vjeçare e sorollatni nëpër korridore dhe dyer të mbyllura, duke mos e takuar që nga marsi i vitit 2024. Kërkesa e vetme e tij, pra ky takim nuk bëhet vetëm për një kërkesë të vetme të tij legjitime, pra një ashensor në banesën e tij, dhe ai këtë kërkesë e ka bërë duke u mbështetur në premtimet e juaja elektorale, ku si në fushatë apo si projekt elektorale keni pasur ndërtimin e ashensorëve nëpër banesa të ndërtuara para dhe pas luftës, gjë të cilën nuk e keni bërë. Dhe kjo, ky problem i bacës

Alush, nuk është vetëm i tij, është i dhjetëra pleqve të tjerë të cilët banojnë në katet e pesta dhe të cilat gratë e tyre janë të ngujuara në ato banesa. Në këtë rast, bashkëshortja e bacës Alush ka me muaj të tërë e cila nuk ka asnjë mundësi që të dalë nga banesa e saj për t'i kryer shërbimet e nevojshme jetike të saj. Prandaj kërkoj, nga kryetari i komunës në këtë rast, meqënëse drejtorja e mirëqenies dhe e urbanizmit e kanë neglizhuar dhe në kodet e tyre buxhetore nuk e kanë paraparë një të tillë, që sa më shpejt që është e mundshme, t'i gjendet zgjidhja këtij qytetari dhe shumë qytetarëve të tjerë, sepse jeni kryetar i të gjithë qytetarëve pa përjashtim moshe dhe së paku ta takoni, t'ia dëgjoni hallet e tij. Meqënëse nuk e keni pranuar bacin Alush, unë të gjitha kërkesat e bëra zyrtarisht po t'i dërgoj ty kryesuese në mënyrë që t'ia përcjell kryetarit. Kurse për pyetje të tjera kam shumë pyetje të tjera, por meqënëse nuk është nuk janë drejtorat këtu, atëherë s'kam edhe kur po jenë nuk po japin përgjigje lej më që s'janë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit shumë Karanfil. Ju lutem ta respektoni të mundoheni edhe kohën. Faleminderit. Po. Faleminderit. Do të ju a përcjellim patjetër. Ertan Simitciu fjalën e ka.

Ertan Simitçi: 00:06:51-00:09:28

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Simitciu. Fjalën e ka Shukri Quni.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje, kolegë kuvendar. Përshëndetje, media, të gjithë pranishëm. Kam një në fakt një rikërkesë, çështje me ngritë, është fjala për Drejtorinë e Arsimit, çështja e kulmit në shkollën fillore Luigj Gurakuqi në Nashec. Unë kam kërkuar në fakt për me ju ndërruar ose me u rregulluar ajo pjesë e kulmit. Drejtoresha tha që mbetet për vitin 2026 për me u rregulluar sepse ashtu kam bërë kërkesën unë. Unë kam bërë kërkesë që të ndërtohet në vitin 2025. Edhe ato çfarë keni pasur ju me riparuar thashë me i përfshi të gjitha me rregulluar në 2025, ose për 2026-ën mos e lini, kryeni tash në 2025-ën. Qysh do që e keni planifikuar, mos të pik kulmi. Se po e shoh që nuk nuk do të rregullohet. Kam bërë kërkesë për rregullimin apo riparimin e Monumentit të Lirisë tek posta, te Lapidari i Heroit të Kombit, Remzi Ademaj. Nuk e di cila drejtori e ka. Unë i kam drejtuar Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport. Drejtori s'qenka këtu. Qe tre vite është bërë kjo. Më kanë detyruar me bërë projektin me nxjerrë lejen prej trashëgimisë kulturore atje që është. Të gjitha kanë qenë dokumente të gatshme që tri vite nuk është punuar. S'po di qysh po mundeni me shkuar me u afruar te Lapidari. Edhe shkronjat e dëshmorëve e heronjve aty i mungojnë. Cila drejtori e ka po bëj pyetje këtë? Drejtori i Kulturës thotë nuk e kam. Drejtori i shërbimeve publike thotë jo. Cila merret me këtë? Plus lapidari që kam bërë kërkesë në Nashec është komplet i shkatërruar. Vjen një firmë aty, punon diçka dhe menjëherë largohet pa kryer asnjë punë. Pastaj kam bërë një kërkesë, drejtori nuk qenka këtu i shërbimeve publike. Ne kemi wc-të edhe në oborr të shkollës, wc-të i kemi me gropë skeptike. Kam kërkuar prej drejtori shërbimeve publike që edhe një lagje aty me u përfshirë me atë kanalizim edhe me u lidhur në kanalizimin kryesor, edhe ata janë me me gropa skeptike, domethënë që i kanë në oborr gropet e wc-ve. Drejtorja e Rinisë, Kulturës dhe Sportit kanë bërë kërkesë për rregullimin e një fushe sporti në Nashec. Nuk e di unë me çfarë punë është ka merret ky fare drejtori, se është ngarkuar tepër, tash kogja vetës i ka vnu barra të rënda, po mbasi s'qenka këtu ndoshta kthehet edhe bisedojmë pak më gjerësisht. Drejtorja e turizmit, çka o ka bëhet me ato punime më në Nashec burrë? Tash aty kemi bërë fotografime që janë ka vijnë edhe duke derdhur edhe materiale edhe

bërllloge. Ajo është bërë si deponi e mbeturinave aty. Këtu ka përgjegjësi të madhe edhe hidroregjioni jugor por edhe ju si drejtori që e keni bërë aty vendin në deponi. Ja hajdeni i pastroni aty ato, ja le të rregullohet. Këto janë dy sende tashmë. S'kemi çka zgjatëm këtu. Plus kemi bërë një kërkesë për, fjala për drejtorinë e shërbimeve publike për me u ndërtuar një rezervar i ujit në fshatin Nashec. Edhe Atmaxhë është, është kufij është. Është dashur edhe nënkryetari me më ndihmuar këtu. Këtu i falenderoj kolegët kuvendar që kanë votuar buxhetin kur kanë hyrë 70.000 euro janë ndarë prej këtij kuvendi edhe kryetarin po ashtu e falenderoj që më ka përkrah. Ndërsa ushtrues detyra ekzekutiv çka është ajo atje në hidroregjion, ai zotnia atje nuk e ka parapa. Domethënë më mirë është me u ngarkuar pompat e ujit në Nashec, me një rezervar që i furnizon me Grazhdanik, e me Kobajë, e me Vlashnje, e Atmaxhë, e Nashec, e Tupec, e lagja Jeta e Re, se sa me bë edhe një rezervar tjetër që me i ndihmuar atyre pompave të ujit. Nuk e di çfarë eksperta jemi ka prodhojmë ne këtu, a kanë farë shkolle ata, a dinë ndonjë send, a jo a? Edhe drejtor i turizmit. Bisedo me drejtorin e hidroregjionit jugor, mos na shtini llugave kot. Punëmarrësi afër burimit, i ka lënë do gypa, tash madhësia s'po di sa është, janë gypa të betonit, për me larguar prroin. Ata gypa janë drejtpërdrejt në burim të ujit të pijshëm. Le t'i heqë ata gypa prej aty, se është ka e ndotë ujin e pijes. Nuk ka nevojë me ngritë çështje këtu e mos me u kry punimet. Ato çështje që ngriten këtu edhe ato probleme unë kërkoj prej drejtorëve me i kry këto. Nëse ju nuk i kryeni unë nuk e di atëherë çka bëjmë ne ose çfarë roli kam unë këtu ose kuvendarët e tjerë. Gjithë kohën të njëjtat pyetje të njëjtat çështje që janë tu ngritur. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Quni. Fjalën e ka Selman Sokolaj. Përgatitet Florent Ukaj.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Kryetari Totaj me të marrë mandatin ndër punët e para që ka pas bërë ka qenë ndalja e shujtave për nxënësit e klasave të para deri në të katërt. Ndërsa tani ka ardhur situata që edhe në çerdhe bukën e marrin fëmijët me vete. Çfarë degradimi. E dyta. Kushdo që ka pasur pretendime në media të prindërve. Kjo është shumë e vërtetë. Nuk e di pse po reagon kështu drejtoresha arsimit. Edhe Totaj mbasi s'është marrë me punë që i takojnë, është marrë përshembull me çështje nacionale, është marrë me veriun. Në zgjedhje nacionale, në fshatin e tij në Gjonaj, Partia Demokratike që përfaqëson Totaj ka dalë e treta. Domethënë e ka marrë mesazhin e qytetarëve për ata që ka marrë. Kryesuese, çka flas unë, e kemi nuk tregon ty Shaqir Totaj çfarë flas unë. Unë mundem me folë diçka që hiç s'të pëlqen ty, po ajo është çështja e imja, kështu që jemi në rregull. Domethënë është marrë me çështje nacionale, s'është marrë me çështje lokale. Për çështje nacionale, fshati Gjonaj ja ka dhënë përgjigjen, është subjekti i tretë pas Vetëvendosjes dhe LDK-së. Për drejtorin e shërbimeve publike, që në këtë rast mundet me qenë edhe kryetari i informuar, çështje lokale kryesuese, është thelbësisht kjo lokale, ka të bëjë me kontratat e ndriçimit. Unë kam disa pyetje për drejtorin, po edhe për kryetarin, mbasi kryetari mundet me ditë, drejtori s'qenka këtu, a po hetohet projekti 2.5 milion eurosh i ndriçimit? A është intervistuar nga krimet ekonomike ose prokuroria për këto projekte drejtori? Edhe a janë kryer pranimet teknike për ndriçimet e vendosura në disa fshatra. Për drejtorin e DKRS-së, me të filluar mandatin në kornizën afatmesme buxhetore janë parapa tri herë nga 1 milionë euro për ndërtimin e Has Arena më duket i keni pas quajtur. Madje edhe privatisht i keni marrë qytetarëve të holla. Nuk e di çfarë ka ndodhur me to, a ju kanë kthyer qytetarëve ato të holla që i keni marrë. 2022 janë paraparë 1 milion euro, 2023 1 milion euro, 2024 1 milion euro, gjithsej 3 milion euro. Që do duhej që në fund të 2024-se tash ai do të pritej shiriti, tash aty po shohim disa punime, kush po bën

punime, a ka projekt, a ka kod buxhetor, çfarë është duke ndodhur aty? Te drejtoresha e arsimit, seancën e kaluar nuk kam marrë përgjigje, e kam ngritur çështjen e transferimeve, çështjen e honorareve, domethënë kanë vazhduar me u lajmëruar profesorë arsimtarë të ndryshëm edhe për honorarët edhe për transferimet që dyshohen që janë të kundërligjshme, e kreu kryesuese edhe pak. Për drejtorin e administratës, drejtor, në hyrje të administratës aty në komunë, është dera që thotë mos e shty. Mirëpo ajo dy herë pa e shtypur nuk hapet, nuk mundet me hy një qytetar me i kry shërbimet. Është problem i aty për atyshëm apo është problem që nuk po merr zgjidhje. Se besoj që një derë rrotulluese me u rregulluar nuk është ndonjë punë e madhe. Aty mungojnë edhe tualetet që janë ka dy vite më duket që nuk janë të hapur, nuk janë të mirëmbajtura. Është problem për qytetarët, sidomos për qytetarët që janë në moshë edhe që kanë sëmundje kronike. Edhe e fundit kryesuese shumë shkurt, ka të bëjë me drejtorinë e inspektoratave. Drejtor, qytetarët ju thërrasin për me intervenuar edhe njëra prej rasteve, me sa di, ju kanë thirrur te ish-banesat e oficerëve. Ka të bëjë, pretendohet që po uzurpohet një hapësirë aty për të ndërtuar një lokal afarist edhe janë zënë dritaret e banesës kolektive. Tash pyetja është ju, a po përgjigjeni qytetarëve apo po vazhdoni me u marrë me prerjen e shiritave? Se unë po ju shoh veç tu pre shirita të rretheve. Po këtu ka ankesa që s'jeni përgjigj. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Selman. Ju rikujtoj edhe një herë të nderuar kolegë, mundohuni ta respektoni kohën. Ju kuptoj që keni shumë çështje me ngrit edhe ndoshta janë shumë pak të mjaftueshme vetëm dy minuta, po kështu e kemi me rregullore, ju rikujtoj edhe një herë që të mundoheni ta respektoni. Florent Ukaj e ka fjalën paspastaj Petrit Hoxhaj.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Unë sot e kam një pyetje për kryetarin e komunës. I nderuar kryetar, ne si LDK kemi bërë një kërkesë për vendosjen e shtatores së presidentit historik doktor Ibrahim Rugova. Këtë kërkesë ju e keni pranuar dhe publikisht. Madje ne si LDK e kemi votuar buxhetin pikërisht për këtë arsye. Dhe ende asnjë veprim nuk u marr, nuk po shihet që u ndërmarrë për këtë shtatore. Prandaj pyetja ime është kur do të fillojnë procedurat dhe kur do të përfundon ajo shtatore. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Ukaj, fjalën e ka Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë kuvendar. I nderuar kryetar, në fillim të këtij muaji kam bërë një kërkesë të cilën ka qenë edhe për drejtorinë e shërbimeve publike dhe për drejtorinë e emergjencave lidhur me kërkesën dhe shqetësimin e një fermerit që veçse dheu ka filluar t'i rrëshqit mbi objektin ose fermën e tij. Ku ka mbetur kjo kërkesë? A ka shku dikush nga komisioni për ta verifikuar se çfarë gjendje është ky fermer. Ndërsa kërkesa tjetër, i nderuar drejtori i administratës, e di që pat filluar një kërkesë e punëtorëve të komunës rreth pagesës së ushqimit, ku ka ngecur, do të thotë, a janë duke marrur punëtorët e komunës këtë pagesë? Faleminderit.

Agim Muçaj (AAK): Përshëndetje kryesuese, ekzekutiv i nderuar, kryetari i nderuar, koleg të nderuar, qytetar të nderuar. Unë sot edhe njëherë sjell apo ripërsëris një kërkesë që kam bërë para dy vitesh, për linjat urbano ose gjersisht për autobusat. Unë mendoj se komuna e Prizrenit, përveçse ka filluar dhe është mirë që e ka filluar në qytet linjat e autobusve dhe linjat e rregullta nëpër lagje të caktuara, po kërkesa e shumë banorëve të fshatit Korish dhe të rrethinës është që mundësisht të merret një hap, që sa më shpejt të sigurohet linja e autobusave urban, pasi që shumë qytetarë kanë

ankesa dhe vërejte ndoshta edhe me të drejtë, sepse Prizreni domethënë, kjo udhëheqësi mendoj se nuk është veç për qytetin e Shadravanit dhe rrethinës. Mendoj se edhe këto fshatra për rreth janë thuajse lagjet e qytetit. Mendoj se ka mjaft banorë, të cilët kanë probleme, si nxënësit të cilët shkojnë nëpër shkolla, edhe të punësuarit, pra, kanë shumë probleme me udhëtim, do të thotë. Dhe mendoj se kjo do të ishte një përgjigje që do t'ju përshtatet gjithë banorët të rrethinës dhe sigurisht se do të jetë edhe një mirënjohje për vetë udhëheqjen e Prizrenit. Faleminderit.

Islam Thaqi (LVV): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për ju, kryetarin, ekzekutivin, koleg kuvendor dhe mediat të tjerë të pranishmit në këtë sallë. Çështjen që e kam për të ngritur i drejtohet drejtorit të shërbimeve publike, meqënëse një pjesë banorëve të rrugës Asret Poniku kanë kërkuar që ta ngre si çështje, bëhet fjalë për ndriçimin publik. Realisht para disa muajë kemi pasur punime në atë rrugë për zëvendësimin e poqeve. Aty kanë filluar punimet, janë larguar poqet të vjetra që kanë qenë apo komplet ato llambat. Mirëpo që dy apo ndoshta dhe tre muaj nuk kemi vazhdim punimeve. Edhe rruga në gjatësi mbi 200 m-sh është në errësirë të plotë. Do të thotë pyetja ime është se kur do të vazhdojnë punimet aty për t'u vu sistemi i ri i ndriçimit për atë rrugë. Pyetja e dytë është po ashtu lidhet me ndriçimin, po kësaj radhe lidhet me ndriçimin e shumë monumenteve që janë të ngritur nga kuvendi komunal. Me të drejtë La Shuk e ngriti çështjen e lapidarit të lirisë mund në qendër të qytetit, ku edhe më herët është kërkuar të riparohet ajo, meqënëse shumicës i mungojnë shkronjat, mirëpo unë para disa ditëve kam bërë reagim publik për njërin prej lapidarëve apo monumenteve për shkak të mungesës së ndriçimit. Mjafton që të fillohet nga memoriali i martirëve në lagjen Tusuz, ku nuk ka ndriçim. E gjerë në dalje të qytetit shumica e lapidareve apo memorialeve e kanë ndriçimin të dëmtuar. Kërkoj nga ekzekutivi në këtë rast nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të intervenohet urgjentisht meqënëse t'i afrohem qershorit edhe ditës së çlirimit të qytetit. E është e turpshme për ne që ata që dhanë më të shtrenjtën për vete mos t'i nderojmë të paktën në këtë mënyrë duke ja mirëmbajtur monumentet e tyre. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaqi. A ka anëtarë të tjerë apo po kalojmë te pjesa e ekzekutivit në qoftë se nuk ka? A po kalojmë te pjesa e ekzekutivit, kryetar, nënkryetar a keni ndonjë përgjigje? Hajde, drejtoresha, po.

Luljeta Veselaj (D. Arsimit): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, koleg drejtor, të nderuar asamble, media, qytetarë. Po fillojmë me Bajramin. Nuk është këtu, por për hir të korrektësisë dhe qytetarëve, projektet të cilat janë me buxhetim me pjesëmarrje, janë tri projekte në drejtorinë e Arsimit, konkretisht për shkollën në Gjonaj. Veçse projekti është në fazën e finalizimit dhe së shpejti besoj që gjatë javës së ardhshme do të jetë në hapja e thirrjes tenderuese, kurse projekti që ka qenë për sallën e sportit në Velezhë është në thirrje publike dhe për shkollën Hysen Rexhepi është në fazën e fundit të projektimit për rregullimin apo renovimin e shkollës. Ertan, Ertan drejtoria e arsimit nuk jep as subvencione, s'ka mjete financiare për mbështetje të organizatave joqeveritare. Kështu që, për format e tjera kudo që gjejmë ne për bashkëpunim dhe për të zhvilluar aktivitetet jemi të hapur dhe ju japim leje. Sa i përket kulmit i shkollës së Nashecit, drejtoria arsimit ka përfunduar pjesën e vet, duke bërë kërkesën te zyra e kryetarit dhe kryetari e ka nxjerrë vendimin, mirëpo me kërkesën juaj zoti Çuni, keni kërkuar ta anuloni dhe kam mbetur këtu ku jemi. Aktualisht me çështjen e buxhetit nuk jemi mirë, kështu që nuk ka mjete financiare, se jo që s'ka vullnet edhe dëshirë, por do t'i shohim mundësitë se çka mundemi me bë dhe si mundemi me reviduar problemin që e ka kulmi i shkollës. Kurse sa i përket zotit Sokoli, jo për t'ju

përgjigjur atij, po për hir të korrektësisë së qytetarëve, çdo fjalë që ka folur për këto tri vite e gjysmë janë veç pa saktësi dhe të pavërteta. Kjo e karakterizon asambleistin dhe këshilltarin e Kuvendit Komunal, zotin Selman Sokoli, dhe unë nuk ndej nuk ndej obligim t'i jap përgjigje, po besoj që të gjithë ata të cilët e kanë dëgjuar për këto tri vite e kanë parë të pavërtetat e tij në vazhdimësi dhe informatat e pasakta të cilat i flet këtu në Kuvendin Komunal. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoreshë. Po, po. Patjetër. Po zotri Quni, ju lutem replikë sa më shkurt.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Drejtoreshë. Unë vendimin e kryetarit e kam pa dhe kam mirëpritur dhe e kam falenderuar për një vendim të tillë. Ka qenë shumë e nevojshme. Ju keni parapa që edhe në vitin 2026 me u ndërru krejt kulmi i shkollës. Unë kam kërkuar që mos të bëhen dy herë investime. Kam thënë që ai investimi i 2026-ës le të vjen në 2025-ën edhe me u zgjidh ai problem. Nuk kam kërkuar sikur që thatë ju me u anulë. Atëherë nëse kam kërkuar unë me anulë, atëherë është gabim total i imi, që s'e kam thënë as atë, por tash po them që rregulloni atë pjesë e cila është e dëmtuar, qysh e keni parapa. Se 2026-ën, nuk besoj që je drejtoresh. Edhe inshallah nuk je. Singerisht po të them.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Replikë zotëri Selman, të lutem sa më shkurt. Replikat e dini që janë.

Selman Sokolaj (LVV): Shumë shkurt, ndoshta 15 sekonda. Drejtoreshë e nderuar, sa herë që kam fol, të kam demantuar tani me fakte. Sa herë që kam fol, kam marrë shpifje, insinuata prej të gjithëve, prej kryetarit në fund. Po t'i përmendi vetëm dy raste. Shkurtime i orarit në Romaj të Hasit, e keni quajtur shpifje, pesë minuta s'ka shkuar, ju kam ofruar dokumentin dhe ma keni kërkuar, nuk ju kam dhënë. A jeni interesuar ju për atë rast që u shkurtua orari? S'jeni interesuar! Edhe rasti në Gjonaj të Hasit. Shkurtime i orarit që ju keni paraqitur mbarëvajtja mësimi shkollor po shkon sipas normave, sipas parashikimeve, prapë ju kam paraqitur dokumentin. Kështu që për çdo përgjigje, unë e kam përgjigjen tjetër, se çdo gjë që ngriti, e ngriti si shqetësim. Edhe transferimin e fundit që e keni bërë, sot s'po e përmendi, e përmendi në seancën tjetër. Ju e njihni kush është personi? E keni transferuar kundërligjshëm prej një shkolle në një shkollë tjetër. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Kalojmë te pjesa e drejtorëve të cilët dëshirojnë me dhënë përgjigje. Kryetari njëherë, mandej edhe drejtoresha Ramize. Ju kisha lutur kryetari e ka fjalën, ju lutem.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Më së pari po do me ju përshëndet se erdha pak më vonesë edhe me ju falenderu për kontributin secili në mënyrën e vet. Veç një citate kam, e di që dikuj i pëlqejnë, dikuj nuk i pëlqejnë citatet. Janë disa njerëz që për çdo problem e kanë nga një zgjidhje, po janë disa njerëz që për çdo zgjidhje e kanë nga një problem. E me këta të grupit të dytë komunikimi bëhet në stilin pa koment, sepse nuk e pranojnë forcën e argumentit, e pranojnë veç argumentin e forcës, kurse ne operojmë me forcë të argumentit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Prej ekzekutivit, ju lutem, prej ekzekutivit a ka përgjigje drejtor, drejtoresha, pastaj edhe drejtori Adem Morina.

Ramize Shala (D. Emergjencave): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar drejtor, të respektuar asambleistë. Unë pata një pyetje prej Bajramit se ku ka mbetur procesi i kamerave. Bajram, faza e parë e kamerave është instaluar në zonën historike të qytetit. Gjë që e keni parë kamerat që janë vendosur aty. Ndërsa për fazën e dytë është duke bërë unaza e qytetit edhe prej qafës kishës deri te Elkosi. Të gjitha kamerat të cilat ne i vendosim, domethënë jemi në dakordim me policinë e Kosovës, sepse ata e shohin të nevojshme se ku duhet me u vendos kamerat. Fillimisht më shumë mjete na kanë shkuar në rrjetet nëntokësore për arsye të kabllimit e për atë punë nuk duken shumë kamera, mirëpo aktualisht jemi duke e shtrirë rrjetin, e shumë shpejt kemi me vendosur edhe kamerat. Sa i përket specifikave, sigurisht që janë në bazë të paramasës, edhe para se me marr kamerat, ne kemi marrë një vendim prej Ministrisë, prej Ministrisë të Punëve të Brendshme, ku na e kanë treguar se çfarë kamera duhet me u vendos. Kështu që, ne kemi qenë në bashkëpunim edhe me ata, edhe kështu që jemi gjithçka në rregull sa i përket cilësisë së kamerave. Janë të verifikueshme dhe nuk ka probleme. Mundet me pasur spekulime, mirëpo në këtë aspekt jemi në rregull. E pata dhe një pyetje prej Petritit. Petrit për shtallen, unë kam qenë vetë në terren, është e vërtetë që ka rrëshqitje të dheut, aty më herët është ndërtuar një mur, mirëpo fatkeqësisht aty ka eruzion edhe është e pamundur ne me intervenuar aty, përderisa pavarësisht që ti ndërtosh mure është i paqëndrueshëm. Kështu që ne kemi rekomanduar që me ju drejtuar Drejtorisë Shërbimeve Publike për arsye të buxhetit se ne e kemi një buxhet shumë të vogël edhe intervendojmë vetëm në raste kur janë shumë emergjente. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtoreshë. Atëherë drejtori fjalën, po drejtor Morina urdhëroni.

Adem Morina (D. Kulturës): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, nënkryetar, koleg, të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë, dhe ju media. Në lidhje me pyetjen e parashtuar nga kuvendari Florent Ukaj, që u drejtua kryetarit, do të jap përgjigjen ngaqë jam duke u marrë drejtpërdrejt me projektin fjalë, për shtatorin e presidentit Ibrahim Rugova. Ka qenë e planifikuar në buxhet të vitit 2025. Ne kemi si kod buxhetor dhe jemi marrë me projektin realisht. Projektin e kemi në zyrë, mirëpo lokacioni i cili është parapa për ndërtimin e shtatores së presidentit Ibrahim Rugova, ai është një vend i cili është votuar në asamble, dhe aty parashihet ndërtimi i shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari dhe unë jam në kontakt me edhe me shefin e grupit juaj edhe me njerëz të tjerë. Kemi lypur propozime të tjera, sepse ku është ndonjë lokacion më i përshtatshëm që të vendoset shtatorja e presidentit Ibrahim Rugova dhe po presim që brenda brenda javës ndoshta na vjen ndonjë propozim dhe ato propozime t'i shikojmë ku është një pozicion më i përshtatshëm, që një figurë e tillë ta ketë një vend aty ku e meriton. Sa i përket pyetjes së parashtuar të zotit Shukri quni, edhe pse isha gjatë rrugës duke ardhur, por sigurisht ishte pyetja për lapidarët nëse jam i saktë la Shuk. Memorial. Isha në telefon duke e dëgjuar gjatë rrugës edhe edhe përcjella live kështu. Kështu që, pyetjen e ke parashtuar edhe më herët. Ju kam përgjigjur edhe më herët. Ne e kemi një kontratë me një operator ekonomik e cila e ka Drejtoria e Kulturës që e ka mirëmbajtjen e memorialeve dhe gjithë lapidarëve. Dhe brenda asaj kontrate ju kemi përgjigjur, e kemi pru kompaninë, operatorin ekonomik, në vend të ngjarjes, për ta bërë mirëmbajtjen në këtë rast renovimin e memorialit. Mirëpo, operatori, i cili ka ardhur në vend të ngjarjes, nuk e keni pranuar fare, sepse i keni thënë, ti nuk bën me punuar këtu. Dhe ky është argumenti i cili ma ke thënë edhe vetë, edhe unë po ta demontoj edhe njëherë. Ne q'atë kompani e kemi të përzgjedhur, unë s'e kam përzgjedhur, e ka përzgjedhur zyra e prokurimit dhe nëse përsëri

je dakord, sepse memoriali është me të vërtetë një vlerë që duhet me renovuar, jemi të gatshëm përsëri me dërguar firmën dhe me kryer shërbimin. Po të njëjta gjë, në këtë asamble, atë ditë kur unë kam liruar asamblenë, është thënë që punët të cilat nuk janë kryer nga operatorët ekonomikë janë kryer pagesat. Asnjë pagesë nuk është kryer. Unë s'mundem me i ndalur njerëz të tjerë në asamble, po përgjigjja. Kështu që, zoti Quni, përsëri jemi të gatshëm. Nëse është e nevojshme ndërhyrja në memorial, e dërgojmë operatorin ekonomik i cili ka kontratë edhe normal që duhet me u bërë mirëmbajtja e memorialit në këtë rast të Lapidarit. Zoti, Sokoli, e di që kemi bërë planifikime të më hershme, sepse kemi dëshiruar me pasë një pjesë të tillë të ndërtimit të një terreni sportiv, mirëpo në mungesë të mjeteve buxhetore nuk kemi mundur të arrijmë ta bëjmë planifikimin ashtu qysh është dashur. A sa i përket mjeteve, e kam thënë edhe disa herë ke bërë pyetje, ke parashtrë pyetje, ne si drejtori dhe si drejtor nuk kemi marrë mjetet Selman. Për pjesën e projektit janë marrë njerëz vullnetarë. Ne nuk kemi organizuar dhe nuk ka asnjë mjet të marrë nga ne si drejtor dhe nga drejtoria për e sportit në këtë rast. Faleminderit për vëmendjen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtor. Po, po urdhëro zotëri Quni.

Shukri Quni (Nisma): Drejtor, faleminderit që ke përcjellur edhe e paske kuptuar pyetjen por edhe një ka qenë për një, për rregullimin e një fushe të sportit në fshatin Nashec. Kam bërë disa kërkesa aty, bile nënkryetari ka qenë atëherë ministër në Prishtinë atje ministër i kulturës, ka pas ndarë 100.000 euro në atë kohë, po nuk e gjet domethënë mbështetjen këtu te ish-kryetari më herët kur ka qeverisë, edhe shkuan ato mjete, shkuan ranë në ujë, domethënë nuk erdhën te ne, u investuan në dikënd tjetër. Drejtor, që tri vite e gjysmë po bëhet qeverisje. Ku je që aty ulen, edhe unë të kam pru, mos harro. Po para se me ardhë ti ku je kryetar i partisë në Has, ta kam shtrë asfalt unë në krejt rrugën, me shokët të mi, jo vetë. Unë gjithë nuk tham unë, po me shokë. Edhe ke ardhë ti në sofër të shtruar, hazër, gati. Asnjë mund ti s'i ke që e ke bërë, ku je aty! Këtë mos e harro. Gjithë duhet me këqyrë ka ke ardhë. Kurrë mos i nënçmo ata të cilët kanë ndihmuar pa interes personal. Unë këtu asambleisti i parë jam në këtë kuvend. Sa vjet nuk e di veç, merri llogari kur e mbaru kjo shtëpia e bardhë. Hala interes personal nuk kam kry këtu. Veç nëse e di dikush sa maja e gjilpërës le të ma thotë, haptas. Interes personal a di ç'ka? Mu me më shti në punë, kurrë nuk më keni shti në punë hiç ju. Fëmijët të mi, familjarë, asnjë hiç. Interesi i qytetarit më ka pru mu këtu. Rrugë, kanalizime, sidomos pika më e dobët e jemja është monumenti i dëshmorëve dhe herojve. Kam pas fatin me u kon me ta, se me i pas pas këto mend sot, kisha vepruar sikur ti. Edhe do shokë të tjerë tutë që janë. Po kam pas fatin me u kon me ta... Kryesuese, më ka dhënë përgjigje, ma ka përmendur emrin, duhet me dhënë tash, me fol, se boll më. Te monumenti i kulturës, te monumenti i herojve, monumenti i lirisë, më keni detyruar me bë projekt, kam bë projekt. Tri kopje, ani që e keni humbur ju atje, unë i kam edhe dy të tjera. E kam dorëzuar një edhe në shoqatë të veteranëve të luftës. Kam marrë edhe lejen prej Samir Hoxhës, bile një djalë aty tash emrin s'më kujtohet, e ka bë atë projektin pa asnjë cent. Vetë e ka bë. Asnjë ndërhyrje s'i ke bë. Tash po dilni se tjetër kush, tjetra drejtori e paska me i rregulluar monumentet. Te monumentin në Nashec, është shumë e vërtetë. Po unë nuk kam shkuar nga ajo mos me u rregulluar, po kam shkuar me u rregulluar me u bë mirë. E jo me ardhur me shpërla aty pare. E ke qashtu edhe në Kojush. Paret i ka marrë, punë s'ka kryer. Po ti i përmendi prapë, e ke edhe në Lez. E ke edhe në Kushni. E ke edhe në Nashec, e ke edhe këtu. Tjerët i dinë këtu, kush janë këtu asambleistët. Paret janë marrë, punët s'janë kryer. Shukri Quni është kundra kësaj drejtor. Edhe hiç se kam dert këtë punë. Edhe ju kam thënë kur keni ardhur në pushtet. Nëse Shukri Quni ta lypni një punë personale me kry, dy duart i këpus. Jo

ty, po edhe ku edhe të tjerëve çka janë. Para jush janë kanë. Personale s'kam ardhë me kryer punë këtu. Personale janë ata të tjerët mos të hyjmë tashë këtu me fol. Edhe më shumë kryjnë ata punë se sa unë. Qeshtu drejtor! Këqyre rrugën ka ke ardhur deri aty. Unë jam argat të cilën e kam bërë me ardhur ju këtu. Se ish-drejtori kulturës edhe një ish-drejtor i shërbimeve publike, ata janë shkarku prej detyre. Mos e ditç' ti, të kallëzoj unë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem për mirëkuptim. Po edhe Selmani e ka të lutem replikë sa më shkurt.

Selman Sokolaj (LVV): Zoti Morina, sigurisht që ju të hollat i keni marrë në emër të Partisë Demokratike për shkak se as s'keni qenë drejtor, as PDK-ja s'ka qenë në pushtet. Ju keni qenë prezent. E dyta, arsyeja pse kryetari, neve s'po na përgjigjet, a di cila është? Ai nuk mendon që duhet me u përballë me asambleist, ai mendon qysh thotë në audioincizimin e famshëm që duhet me i blerë asambleistë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtori ta ka bërë replikën, jo kryetari. Emrin ta përmendi drejtori.

Selman Sokolaj (LVV): Kryetari, të gjithëve na ka bërë. Kryetari i komunës thotë që asambleistët duhet me i blerë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka prej ekzekutivit ndonjë pyetje tjetër? Po me shtu diçka, po drejtori fjalën e ka.

Adem Morina (D. Kulturës): Për shkak të korrektësisë zotit Quni po i them kështu, sepse edhe në para dy seancave ka thënë këtë gjë. Nuk është punuar aty, s'është punuar aty, s'është punuar aty dhe paratë janë marrë. Është e pavërtetë. Është, është shumë e pavërtetë është. Unë nuk flas me të nime La Shuk, po flas me argument. Hajde në drejtori edhe këqyre a janë paguar apo s'janë paguar. E këto të ofrojmë, të ofrojmë, të ofrojmë, po ti po e di që janë paguar. Asnjë punë që nuk është kryer nuk është paguar. Kështu po them me plot argumentin e fjalës. Kështu që s'janë paguar. Unë dëgjova, sa sa sa i përket terrenit sportiv. Terrenit sportiv ju kemi ofruar që fushën e futbollit në Nashec, ta e rregullojmë. Keni refuzuar, keni thënë që na duhet një fushë tjetër një terren sportiv në fshat. Ju kemi treguar se nuk kemi kod buxhetor të shtrimit të asfaltit. Në momentin që fusha rregullohet me asfalt jemi të gatshëm me shtruar me tartan dhe me bar artificial. Kështu ka qenë përgjigja la Shuk.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, a bën veç një një shkurt? Është hera e fundit që kështu në mënyrë arbitrare na e ndal mikrofonin. Është e disa herë, e qindra herë. Ju nuk e përcaktoni çka flet një i zgjedhur i qytetarëve të komunës së Prizrenit. Ju, as Shaqir Totaj, përndryshe, është sjellje shumë arrogante që po vazhdon që tri vite e gjysmë. Nuk mundeni me vazhduar kështu seancat. Ju edhe në opozitë, edhe në pushtet e luani rolin e gangsterit. Po tham, mos na e detyroni mos me mund me vazhdu seancat në këtë sjellje. Kur keni qenë në opozitë, jeni sjellë në mënyrën më arrogante të mundshme, më të ashpër, më të pistë me drejtorët që kanë qenë atëherë. Tash tu qenë në pushtet, silleni në këtë formë me ne. Po të paralajmërojmë edhe një herë, jam tu folur në emër të grupit. Nuk mundeni me vazhdu seancat nëse vazhdoni në këtë formë. Ju lutem. Është shumë sjellje e turpshme kjo. Nuk e përcakton ekzekutivi çka flet një asambleistë. Është e tmerrshme kjo! A i ke lexuar rregullat e asamblesë? Ekzekutivi nuk ka të bëjë fare me asamblenë. Është pushtet

tjetër. Ju jeni udhëheqëse e pushtetit legjislativ. Edhe ju e dëgjoni Shaqir Totajn anash, djathtas tjetrin, majtas tjetrin, para, pas, kush tregon kuj me ja ndal fjalën. Disa herë nga këtu tu është bërë me gisht ma ke ndalur fjalën. Disa herë Shaqir Totaj të ka kërkuar me e ndal fjalën, ma ke ndal fjalën. Disa herë të ka kërkuar ai anash. Ky drejtori aty, ai drejtori aty.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjo tash, të lutem veç të kesh durim. E more fjalën e kërrove, mbi katër minuta i kalove. Për respekt qysh i respektova edhe kolegët paraprakë, edhe ti e pate mbi katër minuta. Pavarësisht kush bën me gisht çka thotë, aty ku e konsideroj veten që kam të drejtë, nuk ta ndala fjalën. Po në momentin kur erdh, drejtori po bën replikë, drejtori ta përmendi emrin, po thua kryetari, unë nuk e di çka tha kryetari, çka të tha ty. As ta përmendi emrin, as nuk pate replikë. Në rregull jemi. Replikat që ju takojnë, që i dini që janë dy minuta, deri në dy replika në rregullore, unë me sa po e shoh. Edhe pse i bëhet replikat mbi katër minuta, edhe zotëri Çuni, edhe ju.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesuese, kur ka filluar minutazhat, kush e ka respektuar i pari minutazhat?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Edhe unë po dua me ju mirëkuptuar që dy minuta nuk po ju mjaftojnë.

Selman Sokolaj (LVV): Kush e ka respektuar i pari minutazhat?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ato fjalë që i përmendet që s'po du me ti përsërit, se i mbajta në mend krejt, ato ndoshta e konsideron ti veten ashtu, kështu që unë nuk e ndiej veten, aspak arrogante. Po mundohem secilin prej jush me e respektu në mënyrën më maksimale. Tash juve si ju duket, mua më vjen keq, në qoftë se ti më mendon mua qaq arrogante edhe qaq që nuk po të jap drejt. Ja ti ke fol sot dhe çdo seancë ja mos thotë asnjëri prej këtu. Kështu që

Selman Sokolaj (LVV): Veç një sqarim kryesuese, kur ka filluar minutazha, ju vetëm keni thënë i pari person që ka respektuar minutazhin, një minutë e 59 sekonda kam qenë unë, apo?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Shumë mirë.

Selman Sokolaj (LVV): Po s'u respektuar kurrë ajo. Unë s'kam mundur me i bërë as dy pyetje, të tjerët i kanë bërë 12. Atëherë Mirë ku është ideja e rregullës këtu.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Okej, në rregull. Kur mundesh me i respektu, në rregull. Kur s'mundesh edhe unë po kam mirëkuptim. Besoj që shumica prej juve sot e keni e tejkaluar minutazhin, po ju mirëkuptoj. Për mua rrimë edhe 24 orë këtu nuk e kam problem. Po të jetë mirëkuptimi i dyanshëm. Sikur unë ç'po kam mirëkuptim te ju, po kam dëshirë edhe ju ndaj meje. E jo me na quajt me ato fjalë të pista, arrogan. Kështu që juve qysh ju duket, ajo e keni për vete. Faleminderit. A ka dikush tjetër prej ekzekutivit? Në qoftë se jo, atëherë edhe ekzekutivin edhe të gjithë juve anëtarëve, të cilët dhatë kontribut në këtë pikë, po ju falenderojmë. Po kalojmë te pika e radhës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vitin 2025;

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtori i financave e ka fjalën.

Sulltan Badalli (D. Financave): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për kryetarin, ekzekutivin dhe gjithë ju kuvendar. Pra kemi një propozim për bartjen e mjeteve vetanake të vitit 2024 në vitin 2025, e cila procedurë parashihet edhe në ligjin mbi ndarjet bujqëto-re. Pra në këtë propozim bëhet bartja e mjeteve të tejkaluara të pashpenzuara nga viti 2024 në 2025 me vlerë për 1.205.617 euro. Dhe ato ndahen nënë këto drejtori. Te në arsim kemi në kategoritë ekonomike shërbime komunale barten shuma me vlerë prej 23.798 euro, ndërsa të për mallra dhe shërbime 129.882 euro. Si dhe paga bartet me vlerë prej 45.000 euro. Ndërsa në shëndetësi kemi një vlerë minimale prej 2.491 euro. Ndërsa te Zyra e kryetarit kemi një bartje mallra dhe shërbime me vlerë prej 50.000 euro. Ndërsa pjesa tjetër ka shkuar të gjitha në shpenzime kapitale prej një vlerë prej 954.444 euro. Te shpenzimet kapitale besoj që e keni edhe tabelarin. Ndoshta sdi a është e arsyeshme me me lexu. Pra kjo është një bartje e mjeteve nga viti 2024. Atëherë kisha kërkuar prejjuve që të votohet, është një procedurë e rregullt si përvjet që përsëritet. Po ashtu parashihet edhe njëherë po theksoj në ligjin mbi ndarjet buxhetore. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtor. Po kalojmë te pjesa e kuvendarëve, po zotëri Haxhillari pastaj edhe Islam Thaçi. Rreth kësaj pike kush dëshiron me e marrë fjalën mundet me u lajmëru.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Me vëmendje e pashë tabelarin për ndarjen e këtyre mjeteve vetanake. Për hir të qytetarëve po du pak me e thjeshtësu gjuhën. Këto mjete të hyra vetanake të komunës janë mjete ku qytetari i Prizrenit ka paguar tatimin, pra ku qytetari i Prizrenit ka paguar gjoba të ndryshme, ku qytetari i Prizrenit ka paguar leje të ndryshme. Pra këto këto të hyra janë para të taksapaguesve të Prizrenit. Dhe në qoftëse shohim neve shpërndarjen ku do të bartin këto mjete, me të vërtetë është për të ardhur keq. Duke e ditur që secila drejtori e ka buxhetin të përcaktuar, paramendo në arsim, për shembull, thotë 45.000 euro paga neto përmes listës së pagave. A nuk e ka buxhetin e vetë Drejtoria e Arsimit për paga? Dhe duhet nga të hyrat vetanake për me i qu këto para aty. E tmerrshme! Mallra dhe shërbime. Po ashtu është i njëjti send duke pasur drejtoria e arsimit buxhetin e vet, neve këto taksa vendse apo këto të hyra vetanake, vendse t'i përdorim për projekte të cilat e prekin direkt qytetarin e komunës Prizrenit, neve i çojmë në ato vende ku nuk kemi pasur menaxhim dhe planifikim të mirëfilltë. Po nëqoftëse shkojmë edhe më tutje, e shohim këtu thotë ndërtimi, i rrugës me asfalt me 80.000 euro. Pastaj thotë ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës, 100.000 euro. Shtrohet pyetja, a nuk po dalin 2.5 milionë të cilët i keni planifikuar ju? Apo apo ndoshta edhe karrigat 1.700 euro që i keni parapa, apo parkingjet për biçikleta nga 1.200 euro dhe nuk po ju mjaftojnë paret dhe tash nga të hyrat vetanake të komunës po i bartni në atë projekt. Por edhe është një pyetje direkte që thotë ndërtimin... Projekte ambientale në qytet, në lagjen Ortakoll, Kurill, Tabakhane, Shadërvan, Bajram Curri, Jeta e Re e tjera e tjera me 50.000 euro. Çfarë projekte ambientale janë këtu në fakt? Me 50.000 euro diku gjashtë lagje të komunës së Prizrenit. Prandaj, të hyrat vetanake kisha kërkuar nga ky ekzekutiv që të shkojnë në mënyrë direkte për të mirën e komunitetit, për të mirën e qytetarëve dhe jo në projekte që hashiqare vërehet projekte që nuk e

prekin direkt qytetarin, por për interesat juaja dhe pazaret juaja që i keni. Dhe kjo absolutisht nuk duhet të votohet nga ana jonë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hagjillari, po Islam Thaçi fjalën.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese. Drejtor, meqë është pikë që ju e keni sponsorizuar, dhe në bazë të materialit që na keni dërguar, me sa unë po e kuptoj, do të thotë, edhe besoj se është edhe e natyrshme që të teprojnë mjetet në kategori të mallra, shërbime, siç i cekët ju për disa drejtori. Është e arsyeshme, mundet një po e marr shembull te kategoria paga dhe meditje mundet mos me arrit me kohë me u zhvilluar një konkurs edhe mos me sistemu edhe automatikisht kuptohet që pagat shkojnë në në suficit apo në tepricë. Mirëpo, po mendoj ajo që ju u shmangët është çështja që kemi tepricë jashtëzakonisht shumë të madhe të investimet kapitale. Mua po më habit fakti, shembull, po marr njërin prej projekteve që është shumë vjeçar, ndërtimi i QMF-së tek Kfori nalt, nuk kemi arsyetim pse kanë tepruar këto mjetet. Qysh ka ardhur te teprica e këtyre mjeteve, a kupton? Do të thotë se te investimet kapitale, vlera është shumë e madhe, do të thotë afërsisht 1 milionshi është këtu, 954.444 euro. Edhe këtu se kam të qartë këtë farë kodin, ndërtimi i infrastrukturës nuk është e precizuar ku, ç'ka në lagjen Tusuz. Do të gjitha këto kodet janë të padefinuara. A mundeni me ma shpjegu pse ka ndodhë kjo për shembull te pikërisht te ndërtimi i QMF-së tek Kfori? Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. A ka dikush tjetër që dëshiron me fol? Atëherë po shkojmë me prononcime të shefave të grupeve. Po urdhëro zoti Quni.

Shukri Quni (Nisma): Unë s'po di tash kujt me ju drejtu, drejtori i shërbimeve publike këtu nuk qenka. Drejtori financave. Këtu është kodi 18010. Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Grazhdanik. A janë duke u ndërtuar këtu apo janë ndërtuar më herët? Se unë kam bërë kërkesa këtu për fshatin Grazhdanik. A është që duhet me u paguar këto borxhe apo kanë me u ndërtuar në fshatin Grazhdanik rruga dhe kanalizime? Sepse u kanë bërë kërkesë për ndërtim të infrastrukturës në Grazhdanik. Rrugë, kanalizim, mur mbrojtëse edhe ndriçim. Pyetja është a kanë me u paguar borxhet apo qëto ka me filluar ndonjë projekt i ri drejtor?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtor, a do me u përgjigjur apo i merr pyetje të gjitha? Po urdhëro.

Sulltan Badalli (D.Financave): Faleminderit la Shuk. Te kodi 18010 te i Grazhdanikit këtu është projekti ka qenë veç në vazhdimësi. Tash me siguri më herët është punuar. Mirëpo mjetet janë ndarë për mungesë të mjeteve dhe normalisht bartja për atë punë është hyrave që që nuk janëshpenzuar vitin e kaluar, shpenzohen edhe dedikohen nëpër projekte, nëpër kode qysh ka nevojë, ku është më e arsyeshme me i me i drejtuar për me i kryer punët që kanë mbetur. Kjo është arsyeja, mjetet që bartën. Njëjtë e kemi edhe te QKMF-ja 200.000 euro që e përmendi Kforit, Islami, aty nuk kemi pasur tepricë, por mungesë kemi në atë mjeteve dhe është dashur me i nda 200.000 euro për me u finalizuar projekti. Edhe sa e di unë është, bile është gati në përfundim ndërtimi i QKMF-së në Kfor. Jo jo për Islamin, për Islamin këto. Për Grazhdanik, la Shuk aj ;sht; projekt ekzistues që është punuar në Grazhdanik dhe ne kemi nda mjete se ka pasur nevojë aty, po. Faleminderit.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. I nderuar drejtor, tek kodet që është për fshatin Kobaj 52137, që do thotë i ndan mjetet 24.444.91. A janë të mjaftueshme këto mjete për ta përfunduar projektin i cili ka filluar vitin e kaluar, sepse me këto mjete a paguhet borxhi ndaj kompanisë apo paguhet vazhdimi i projektit në fjalë? Sepse ne e kemi parë që vetëm janë shtruar disa rrugë, do të thotë janë shtruar me zhavor, por është ndërpre shkaku i mjeteve. Tash, a janë mjete që ju paguhet borxhit vitit të kaluar apo janë mjete për ta vazhduar projektin për këtë vit? Faleminderit.

Sulltan Badalli (D.Financave): Këto janë projekte në vazhdimësi që janë. Normalisht edhe janë ndarë mjetet se ka pasur nevojë. Ne këto ndarje që i kemi bërë janë kërkesat e drejtorëve që vijnë. Ata e dinë më mirë se për projektet e veta, detajet se ku dhe çka. Po përndryshe ky është projekt ekzistues që është veç aktiv, që është tu punuar.

Islam Thaçi (LVV): Drejtor, edhe njëherë për me ja sqaruar qytetarëve, po edhe mua në këtë rast, bëhet fjalë për një shumë prej 1.205.000 euro. E kuptoj që kanë tepruar, nga ku kanë tepruar? A kanë qenë buxhetuar ato?

Sulltan Badalli (D.Financave): Këto janë mjete të vitit 2024, mjete që nuk janë shpenzuar në vitin 2024 dhe janë mjetet prej të hyrave vetanake që na lejohet çdo komune që i bart, se janë mjetet e tyre, ndërsa mjetet e pasqepenzuar të grantit nuk shfrytëzohen se nuk të lejohen. Kjo është, po kjo mjete të pasqepenzuar të vitit 2024 janë këto. Jo, janë mjete, mjete të pasqepenzuar. Një pjesë 200 e diçka mijë euro janë mjete që janë të tejkaluar nga të hyrat, pjesa tjetër janë mjete që nuk kanë mund me u shpenzuar në vitin 2024. Edhe zakonisht barten ata për vitin që vjen, në këtë vit në fakt.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafina Alishani fjalën, pastaj Ertan Simiçi.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese, meqë këto janë nga të hyrat, për shembull kemi pasur disa herë kërkesa prej Këshillit për trashëgiminë kulturore që nuk kanë paga. Kishim mundur ndoshta edhe aty me ja bërë një pagesë atyre sepse ca vite janë ata që nuk paguan edhe punojnë vullnetarisht. Nëse ka vullnet, kishin mundur me pas një kod edhe me ja bërë pagat atyre njerëzve të cilët po punojnë vullnetarisht apo jo? Pastaj, subvencionet a janë kryer të gjitha të vitit të kaluar apo ka ende të papaguara? A ka të papaguara? DKRS-ja i ka kryer të gjitha. Pjesa tek nëna lehona ka filluar pjesë pjesë pagesa. Pse mos me i bartë te këto edhe të hyrat vetanake le të shkojnë te subvencionet, te pagesat të cilat janë edhe nuk janë përfunduar. Pse gjithmonë kjo qeverisje tenton me shtrimin e asfalteve, domethënë secilin buxhet, secilin hapësirë që ju e gjeni, vazhdimisht mundoheni me i me i kanalizuar në asfalt. Ju keni qenë më të zëshmit, të cilët keni thënë që është një qeverisje e asfaltit edhe nuk kemi nevojë. A ka dikush këtë ekzekutiv që mendon për mirëqenien e qytetarëve? A ka ndonjë politikë prej anës të juj që e shtyni përpara mirëqenien e qytetarëve, apo më me rëndësi është mirëqenia e operatorëve ekonomikë edhe dostave të juj? Është singërisht për të ardhur keq, edhe këto investime, tash unë e kuptoj që ka të ardhura më shumë, po janë disa investime të cilët më jeni bërë boz. Sa herë keni me shtrë kubëza edhe sa herë keni me shtrë trotuare? Trotualet që i keni shtruar në këtë mandat janë prish. Janë prish që kur i keni mbrapa shtëpisë së bardhë. Edhe sa herë keni me shtrë trotuare të cilët kanë me u prish mbas disa muajve. Singërisht për të ardhur keq. Kjo nuk bën me u votu. Asesi nuk bën me u votu për shkak që vetëm po punoni për operatorët ekonomikë, asesi për qytetarë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Alishani. Ertan Simiqi fjalën, pastaj Kujtesa Kabashi -Shatri.

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit kryesuese. Te pikat e kaluar Bajrami ngriti një çështje në lidhje me çështjen e kamerave. Këtë çështje ne kemi biseduar edhe disa herë te Komiteti për Sigurim. Edhe drejtoresha disa herë neve na tha që është edhe pak çështja e buxhetit, domethënë ndarjes e buxhetit. Unë kam pritur që në këtë tabelë të shikoj minimum diku nja 100.000 euro për këtë projekt. Për arsye se sa kam informatë sistemi edhe softveri është rregulluar, por na pritet domethënë që të vendosen pajisjet, ato kamerat ku është caktuar sipas projektit vendet. Ka shumë raste që në Prizren edhe qytetarët po edhe policia po ka problem, kur ka ndonjë rast për me marrë këto materialet, po obligohen që të marrin nga kompanitë private, nga pronat private edhe natyrisht që ka problem tani me vërtetu raste të ndryshme. Andaj, po mendoj që kjo çështje e vendosjes së kamerave të përfundohet domethënë ky projekt i kamerave, po mendoj që nga këto projekte të cilat e kam unë përballë shumë më është më e rëndësishme për qytetarët për sigurimin e qytetarëve, se për një asfalt apo për një tretuar apo për një projekt tjetër. Të gjitha kanë rëndësi të ndryshme po po mendoj që ky ndikon direkt sigurimin e qytetarëve apo sigurimin publik në Prizren. Andaj drejtor i financave kërkoj një sqarim që a është mundësia të ndryshohet kjo lista? Domethënë të futen të ndahet një buxhet për projektin në fjalë, apo duhemi të votojmë këtë por ose jo?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesuese, të nderuar anëtarë të kuvendit, ekzekutiv, i nderuar kryetar. Shkurt se Karanfili lypi me qenë kështu thjesht kur e tha pjesën e vet të fjalimit për me qenë më të qartë. Unë besoj që këtu ka edhe asambleistë me shumë mandate edhe ish-drejtor. Edhe kjo bartja është diçka që ndodh çdo vjet dhe është rutinë. Është krejtësisht e qartë. Bartja është plusa dhe minusa. Aty ku ka pasur mbetje nga projektet e vitit paraprak, merren ato mjete dhe vendosen në projektet e vitit aktual ku ka minusa. Nuk mundet qysh po thotë Dafina me u qit në subvencione sepse subvencionet janë të planifikuara dhe janë me tavan, ato ekzistojnë, janë aty. S'mundesh me bë shtesë subvencioneve me bartje dhe nuk ka nevojë sepse aty ekziston një planifikim vjetor. E tha Karanfili tha duhet bartja me qenë në interes të qytetarëve. Unë këtu me sapo shoh prej këtyre projekteve 90% janë investime kapitale që janë drejtpërdrejt interes i qytetarëve. Sepse nëse ndërtimi i qendrës së mjekësisë familjare nuk është interes i qytetarëve, s'di i kuj mund me qenë interes. Nëse mirëmbajtja, projektet ambientale në lagjet Ortakoll, Korill, Tabakhane, Shatërvan, Bajram Curr, nuk janë interesi qytetar, unë nuk e di i kujt janë tjetër. Nëse ndërtimi i rrugës me asfalt në Manastericë, nuk është interesi i atyre banorëve atje, nuk e di i kujt mund me qenë. Prandaj me lyp sot këtu, me bë ndonjë ndryshim, veçse me thënë që po them diçka, është krejtësisht e panevojshme. Është interes me plotësu këto mjete që kanë mbetur nga pjesa e fundit e vitit në një nga projektet që nuk kanë pasur nevojë me u shpenzuar aq mjete sa kanë qenë të planifikuara. Edhe tjetra, besoj edhe Islami si ish drejtor, e din që në muajin dhjetor nuk realizohen pagesat. Përfundon periudha e fundit e pagesave edhe ato mjete që mbledhen në atë faze, barten me këtë vendim që e ka kompetencë asambleja komunale. Prandaj, për me qenë më racional është vendim që është propozuar prej drejtorive, ka dhe në të tjera projekte minusa, por kjo është mundësia, sepse këto janë mjetet që kanë që po barten për këtë për këtë vit.

Kujtesa Kabashi-Shatri (LDK): Faleminderit kryesuese, unë deshta me u ndal te kodi buxhetor 54615, projektet ambientale. Në qytet thotë në lagjen Ortakoll, Kurrilla, si Tabakane, Shadarvan, unë dua me u ndal tek lagja Jeta e Re. Vitin e kaluar janë ndarë kodet buxhetore për lagjen Jeta e

Re, ndriçim, rrugë, kanalizim. Asnjë projekt nuk ka filluar në këtë lagje. Vetë quhet lagja Jeta e Re që çdo ditë ndërtohen, domethënë shtëpi, rrugët janë në gjendje katastrofë. Rruga edhe rruga kryesore, Hysni Morina, është në gjendje katastrofë që është e shtruar me kubëza. Lene më ato rrugë të tjera që nuk janë prek fare. Unë nuk e di ku do të bartën këto mjete, kur nuk kanë filluar kodët buxhetore aspak me fillu punimet. Kështu që unë I kam kërkuar, domethënë drejtorinë e shërbimeve publike, gjashtë drita afër shkollës me i pru, Haziz Tola, qato drita me muj jemi t'i prit. Nuk e di ka vijnë ato drita, sa duhet me i prit. I kam kërkuar edhe kur është qenë koha e ftoftë, domethënë edhe qentë endacak, nata, fëmijët prej shkollë, domethënë kanë pasur rrezikshmëri, çato drita s'kanë mundur me i vëndu. Nuk e di ka shkojnë këto pare. Lagja Jeta e Re s'ka trotuar, fëmijët që shkojnë në shkollë. Ju e dini shumë mirë këta. Kështu që nuk e di ka bartën këto mjete. Kur s'kanë punuar, s'kanë filluar punimet, kodët që i ndahen për këto rrugë, këto projekte. Faleminderit.

Sulltan Badalli (D.Financave): Po, Ertan për projektin e kamerave. Ne veç kemi ndarë mjete, nga të hyrat e rregullta janë. Po, këta janë të hyrat nga bartja, mjetet e pashpenzuar të vitit 2024. Për projektin fjalë që ishte në kuadër të drejtorisë së emergjencave, mjetet ne kemi ndarë veç. Drejtoresha është e vetëdijshme për të dhe është e informuar. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtor Selman Sokolaj, pastaj Ilir Gashi.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese, zoti Badallaj me ju drejtuar juve a dikujt tjetër se tani dikush tjetër po e merr fjalën në vend të juve sa herë po dëshiron. Nënkryetari foli për interesat qytetarëve edhe duke ju përgjigjur shefit të grupit tonë me idenë që po pretention që nuk është në interes qytetar edhe këto këto këto janë në interes qytetar. Edhe për me cituar kryetarin tonë të famshëm nevojat janë të mëdha, mundësitë janë këto që janë. Atëherë nëse nevojat janë të mëdha, mundësitë janë këto që janë, na duhet një farë ekonomizimi i projekteve. Ekonomizimi i nevojave edhe çka bëjmë ne me të hollat tona i çojmë në trutaret e paplanifikuara që prishen qysh tha kolega Dafina shumë shpejt, edhe nuk i plotësojmë nevojat bazike të qytetarëve. Për shembull, nevojë bazike e një qytetari që e ka pësuar një fatkeqësi nga zjarret në komunën e Prizrenit. Më duket dy seanca më herët, drejtoreshën Ramize Shala e kam pyetur, a janë kompensuar familjet që kanë pësuar fatkeqësi nga zjarri? Ka thënë, jo për shkak që mungojnë fondet. Tash ne po i bartim fondet edhe nuk i kemi prioritet familjet personat, qytetarët e komunës që kanë pësuar nga fatkeqësitë, që normal në një logjikë normale të rrjedhjes së gjërave do të ishte superprioritet ajo, po të hollat po i çojmë në një projekt tjetër që mbasi është ndërtuar, kanë shkuar në avans, nuk e kanë paguar, tash duhet me i bartë mjetet për me pagu atë projekt, për shkak se s'e kanë planifikuar mirë. Kështu që, unë dashta me pyet drejtoreshën, a ka kërkuar kjo prej drejtorisë financave që kur të bëhet bartja, me i plotësu këto nevoja, se po mendoj që emergjencat janë prioritare. Gjëra të tjera tani në bazë të mundësive. A keni kërkuar edhe a keni një plan me i kompensuar qytetarët? Për shkak se ka qytetarë që janë dëmtuar shumë nga zjarret edhe ende s'kanë marrë kompensim. Me sa kam dëgjuar ka edhe në mesin tonë kolegë që ndoshta i vjen keq me thënë, mirëpo do të ishte e padrejtë që edhe ata, edhe kolegët, edhe kushdoqoftë që pëson një fatkeqësi, komuna me i ndenjtë afër edhe në bazë të ligjeve, rregulloreve që i ka. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ilir Gashi, fjalën e ka.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese. Përsëritje për kryetarin, ekzekutivin dhe të gjithë kolegët. Sa i përket bartjes së mjeteve, një pyetje për drejtorin e financave. Sa është borxhi i komunës karshi operatorëve ekonomikë dhe nga këto mjete që kanë tepruar, a nuk është mundur me u kthyer ndonjë pjesë e borxhit, nëse ka borxh komuna ndaj operatorëve ekonomikë. Ndërsa sa i përket linjave buxhetore që është parapa bartja. Para se të bëhet, para se të merret këtu vendimi, do të ishte mirë që të ketë diskutim në kuvend me me kuvendarët, të merren idetë, propozimet, mendimet e kuvendarëve dhe pastaj ekzekutivi ta përgatit propozim bartjen dhe ajo të votohet, por jo të sillen këtu gatshëm, sepse po e shohim për shembull që sërish po ndahen mjete për trotuare, ndërsa për trotuare janë harxhuar mbi 1.5 milionë euro. Për shtratin e Lumbardhit poshtë urës së Xhevisë është ndarë mbi 2 milionë euro, tash edhe 100.000 të tjera. Pastaj kemi tranzitin ku janë ndarë 70.000 euro, ndërsa dy herë është shtruar asfalti për shtresën e parë. Çka është problemi? Do të thotë sikur mos kishin tepruar këto mjete, atëherë çfarë kishte me ndodh me këto, me këto projekte? A kishin me mbetë qashtu pa u investuar në to? Për shembull, ne kishim mundur me pasur pak qasje edhe më kreative, që është në shërbim të qytetarëve dhe përmirësimin e kushteve urbanistike. Do të kishim mundur me këto të holla me bë shpronësim pronave, për hapjen e rrugëve të reja apo zgjerimin e rrugëve ekzistuese, por që janë të ngushta, instalimin e ashensorëve nëpër banesat kolektive të ndërtuara para luftës, apo ndërtimin e ndonjë parku të qytetit që për fat të keq ka shumë, shumë kohë që nuk është ndërtuar asnjë park i ri, vetëm po rregullohen ato ekzistuese. Faleminderit për dëgjim.

Islam Thaçi (LVV): Nënkryetar, e di që në fund të vitit bëhet barazimi, deri me 20 dhjetor bëhen pagesat e fundit edhe thuhet në dhjetor përfundojnë 70% e pagesave, për shkak të alokimit të mjeteve që vijnë nga qeveria. Unë ajo që kërkoja dhe nga drejtori është, jo ku kanë me shku, po nga cilat projekte kemi suficit të mjeteve, meqënëse nga eksperiencia e di që me një projekt që komuna e ka ndërtuar me planifikim 60.000 euro, tenderuar në fund ka përfunduar me 50.000 euro. Po foli nga përvoja ime, 10.000 euro i kam pas suficit edhe kam kërkuar bartje siç po kërkon ju. Unë veç lypa pasqyrën se nga cilat projekte ka pasur tepër në realizim edhe po shkojnë. Mirëpo kur e përmenda QMF-në në rregull është, ai është projekt për komunitetin është edhe shumëvjeçar. Mirëpo qytetarëve duhet me i treguar se këtu kemi pasur kode buxhetore. Edhe projekte, të cilat kanë qenë për katër vjet, është punuar një vjet, edhe ai projekt më ka përfunduar. Janë planifikuar 5 km me u shtruar rrugë nga qafa e Struzhës, nga stanët e Struzhës deri te qafa e Kushninit, janë shtruar veç 1 km. Edhe për çdo vjet është dashur nga 250.000 euro me paguar, edhe më është zhduk ai projekt. Do të thotë vitin e kaluar s'u punuar kurrë. Unë e lypa veç pasqyrën, jo ku keni me i çu mjetet. Po ku ju kanë tepruar mjetet? Qaq, ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Thaçi, nënkryetari fjalën.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): E para besoj që secili prej jush e keni raportin financiar edhe aty fare lehtë e shihni prej ka kanë ardhur mjetet edhe prej ka po barten sot. Shumica e prej tyre janë tejkalimi i të hyrave që duhet me pas parasysh që është tejkualuar planifikimi i të hyrave dhe është shumë mirë kjo. Po ka edhe nga projektet për të cilat Islami ki në raport dhe mundesh me pa' për secilin veç e veç. Një. Dhe e dyta, këtë që e tha Iliri, duhet me pas parasysh, bartja e mjeteve nuk mund me hap kode të reja buxhetore. Ato vetëm barten në projektet ekzistuese. Ato që i përmende ti Iliri, ato krejt duhet me u hap kode të reja për këtë. Po kjo s'ta mundëson. Ky vendim s'ta mundëson. Për me pas kode të reja e kemi buxhetin në shtator, aty mund me pas edhe kode të reja.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit nënkryetar. Atëherë nuk i morën prononcimet edhe të grupeve tjera. Shefi i Lëvizjes Vetëvendosje vetëm se u prononcu që nuk do ta mbështesin, nëse i qëndroni asaj përsëri, apo do ta kesh fjalën përsëri? Po. Po i marrim edhe shefat e grupeve.

Karanfil Haxhillari (LVV): Normal që nëqoftëse e shohim këtu nga të hyrat vetanake, dhe që shumica e të hyrave pothuajse janë nga lejet e ndërtimit, dhe që të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit po shohim se qysh po degradon qyteti pa asnjë plan rregullativ, pa asnjë renditje së paku të atyre ndërtimeve të larta dhe të hyrat e qytetarëve shkojnë në blerjen e veturave për nevojat e komunës së Prizrenit. Në qoftë se kjo është në interesin e qytetarëve, blerja e veturave, nuk di çfarë me thënë tjetër për interesin të qytetarëve. Prandaj, ne jemi kundër.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Haxhillari. Vazhdojmë me PDK-në.

Adrit Kransniqi (PDK): Faleminderit kryesuese, ne si grupi i këmbëtarëve të PDK-së jemi për për me kaluar këtë pikë.

Florent Ukaj (LDK): Na si LDK nuk do ta votojmë këtë pikë, pasi nuk jemi dakord me këtë shpërndarja që është bërë.

Agim Muçaj (AAK): Ne si aleancë, do të abстоjmë.

Shukri Quni (Nisma): Po po ne kemi me përkrah patjetër.

Levent Bus (KDTP): Po.

Ertan Simitçi (Ythp): Ne do të votojmë po me kusht. Me kusht. Po, që në planifikimin e buxhetit të radhës të ketë drejtorja e financave edhe drejtorit përkatëse të cilët kërkojnë këto projekte që asambleistë, asambleja me votu brenda ditës me kusht por për herave të tjera me pas konsultim me shefat.

Sead Arifi (Vakat): Po

Admir Aljilji (SDU): Po

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit. Atëherë jemi në proces të votimit. Ju kisha lutur për pak vëmendje dhe qetësi. Drejtor, ju lutem. Sa jemi prezent? 29 jemi prezent. Kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit i ditës? Ju kisha lutur me e mbaj dorën pak më gjatë derisa t'i numërojmë. 15 jemi për. Kush është kundër? 7 kundër. 6 abstenim. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Ju faleminderit shumë të gjithëve për kontributin. Kalojmë te pika e pestë,

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane;

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Faleminderit kryesuese. Siç e dini e keni pasur edhe diskutim në, po më duket në seancën e kaluar, rasti që ka ndodhur me fatkeqësinë me fishekëzjarrat në lagjen Bazhdarhane pas analizave që e kemi bërë në kabinet bashkë me kryetarin, kemi ardhur në

përfundim që shumicën e këtyre rasteve me mbështet ashtu siç e ka rekomanduar komisioni për vlerësimin e dëmeve edhe e kemi vetëm dy raste me të cilat kemi shkuar me përafërsisht 50%, për shkak të natyrisht mungesës së mjeteve që i kemi. Megjithatë u dashtë me reduktuar një projekt aktual në kuadër të zyrës së kryetarit, për me i dalë sadopak në ndihmë e këtyre rasteve. Ndërkohë, ky raport vazhdon me u bart në qeveri të Republikës së Kosovës, kurdo që ata i shqyrtojnë raportet për fatkeqësitë natyrore, sepse është edhe kompetencë e tyre zakonisht ka ndodhur edhe janë mbuluar këto raste. E po besoj edhe po shpresoj që kurdo që formohet qeveria, do ta trajtojnë edhe një rast të vetëm që ka mbetur me një pjesë të mjeteve pa u financuar. Përndryshe pjesa tjetër duke u bazuar edhe në rregulloren për subvencione, mbulohet me vendim të kryetarit për shkak se shumatat janë të vogla. Ndërkohë, kemi një rast që e kemi sjellë në kuvend e kemi propozuar për shkak se shumata e tejkalon kompetencën e kryetarit e cila parashihet me rregulloren për subvencione. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit nënkryetar për këto sqarime, prej anëtarëve të kuvendit në lidhje me këtë pikë. Kush dëshiron me e marrë fjalën? Po Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesuese. Nënkryetar, ky kuvend e ka votuar si rekomandim listën e tërësishme, e cila ka qenë e raportuar për dëmet që janë bërë. Tash ju po deklaroni që sipas mundësive i keni ekskluduar disa të dëmtuar aty dhe po vinim me një propozim të ri edhe me aludime që ndoshta qeveria qendrore e bën pagesën e pjesës së mbetur. Dua t'ju pyes si ka mundësi që një rekomandim të kuvendit po e bini pa konsultuar në kuvend, pa e diskutuar me shefat e grupeve, edhe thjesht kjo është një mungesë e vullnetit tuaj që nuk po doni me i dalë krah këtyre banorëve. Unë mendoj që është padrejtësi kjo t'i bëhet, sidomos banorëve të cilët janë më të dëmtuar, edhe unë e kuptoj që tash ju mundoheni secilën pamundësi të ju j me me ja aluduar qeverisë qendrore, po buxhet ka. Nëse s'ka buxhet, unë e dhashë edhe rekomandimin tim që le të bëhet me dy pjesë, këtë vit i paguhet 50% shi, vitin e ardhshëm i paguhet 50% shi i mbetur. Nuk është e drejtë një listë e cila është votuar në kuvend me ardhë këtu në mënyrë arbitrare tashmë thënë që ne e kemi menduar që kjo listë është kështu më e mirë edhe po ju sjellim këtu edhe votoni. Nuk është e qartë kjo.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Unë po shpresoj që diskutimi këtu për këtë rast duhet me qenë racional edhe korrekt. E para mos me u shfrytëzuar as politikisht se ai rekomandimi ka mundur me përfunduar me një rekomandim edhe aty me përfunduar gjithçka. Ndërkohë, por që ekziston vullneti, ne jemi sot prapë këtu me këtë pikë. E kemi sjellë në kuvend edhe të gjitha rastet e kemi mbuluar ashtu qysh ka vendosur komisioni i vlerësimit të dëmeve. I kemi vetëm dy raste, për njërin nuk na mundëson rregullorja me e mbuluar 100%, kemi shkuar me përafërsisht përgjys edhe rastin tjetër që e kemi sjellë në kuvend, i cili është i propozuar me u mbulu përgjys. Përndryshe, pa dashur unë me bë politikë, kjo është kompetencë ekskluzive ligjore e qeverisë së Kosovës, jo dhe komunës. Komuna nuk mbulon raste emergjente, s'ka kapacitete. Është heq njëherë e përgjithmonë. Komunitat nuk mbulojnë raste emergjente, fatkeqësi natyrore, çfarëdo që janë ato, sepse s'kanë kapacitete financiare. Edhe kjo është me udhëzim administrativ i ka kaluar qeverisë tash e disa vite. Megjithatë, ky ka qenë rast specifik edhe jemi pajtuar të gjithë me mbulu. Këto janë kapacitetet tona, kemi hequr një projekt përafërsisht rreth 50.000 euro, për me i mbuluar këto edhe ju ftoj me qenë racionale edhe me mbështet këtë propozim. Edhe nuk mund me marrë vendime sivjet për vitin e ardhshëm. Kemi të bëjmë me një buxhet tjetër.

Dafina Alishani (LVV): Pse?

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Kur të vjen koha atëherë flasim. Po sjemi te bisedu ne për Kabin. Jemi të biseduar për një vendim.

Dafina Alishani (LVV): Në rregull. Në seancën e kaluar kur kemi biseduar se qysh mundemi ne me e bë këtë vendim, na është thënë që rregullorja nuk na lejon, sepse ka shuma minimale të cilat i tejkalojnë këto dëme. Edhe e vendosëm me bë me vendim të kuvendit. Nuk e di pse tash nënkryetar po thirrësh në rregullore, po thirrësh në iniciativën e juaj, po juve ju ka obliguar dhe rekomandimi i kuvendit. Ju po ta kishit pasur motivin edhe vullnetin kishit qenë këtu kur është diskutuar atë ditë, edhe ju edhe kryetari. Asnjëri nuk keni qëndruar në sallë, ju s'keni qenë hiç, po kryetari e ka liruar sallën, drejtoritë përkatëse e kanë liruar sallën përveç zonjës Ramize, edhe këtu na keni treguar si ekzekutiv çfarë vullneti keni. Po të ishim drejtuar ose po të ishim orientuar në rregullore, atëherë kish të drejtë nënkryetari çfarë po flet, edhe po rregullorja ta lejon kaq, me kaq mundësi ne e votojmë edhe në rregull jemi, por ne kemi votuar në kuvend. Edhe kuvendi ka kërkuar me u bë mbulimi i shpenzimeve të tërësishëm, jo të pjesërisëm.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Edhe njëherë në kuvend ke dhënë rekomandim. Rekomandimi nuk është obligativ. Nuk keni marrë vendim. T'i kemi të qarta domethënë veprimet që i kemi bë edhe ju edhe ne. Vendimet që i kemi marrë për pjesën dërmuese të rasteve na obligon rregullorja me e marrë në atë formë. Rregulloren që ne e kemi votuar ju. Ndërkohë në raste që dhe e tejkalon kompetencën e kryetarit të komunës e kemi sjellë në përgjegjësi të kuvendit sepse qashtu edhe duhet. Është e vetmja mundësi për me bë këtë zgjidhje. Fondi është ky që është. Po ju them edhe njëherë mos të hyjmë me e politizu këtë rast se mundem ja nis tani me fol edhe për temën prej se ka ndodhur rastet e deri sot. Po votoni mbështetni se familjarët kanë nevojë me i marrë mjetet, janë dëmtuar, edhe vazhdojmë tutje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Florent Ukaj fjalën e ka, pastaj Selmani.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit, kryesuese. Natyrisht se ne si LDK do ta votojmë, jo veç këtë rast që ka ndodhur, po shpresoj mos të ketë raste të tjera, çdo herë do të jemi pro. Po unë tash e kam një pyetje për drejtoreshën e emergjencave. Se sa herë këtu ne kemi bërë, kemi bërë disa kërkesa që të dalim në ndihmë njerëzve që janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë të ndryshme. Këtu na është dalë, na ka thënë që ne si komunë nuk kemi të drejtë. Drejtoresh a po sheh që kemi të drejtë. Po nuk keni pasur vullnet politik. Edhe si po ndjeni tash këtë rast, qysh nesër edhe drejtori i Bujqësisë e ftoj në këtë rast të jetë pak më i zëshëm. S'di unë drejtori i bujqësisë me çfarë do të delë në fushatë në rajonin e Përdrinisë, kur i bëhet një shkelje kaq e madhe atyre personave që janë dëmtuar nga fatkeqësitë. Faleminderit shumë.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. E para, këtu nuk kemi të bëjmë me fatkeqësi natyrore. Kemi të bëjmë me zjarr të shkaktuar nga dora e faktorit njeri. Domethënë, nuk është fatkeqësi natyrore qysh po mendohet me paraqitë nënkryetari, është fatkeqësi që është shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi i faktorit njeri. Komuna e Prizrenit e kemi drejtuar nga këto. Se nënkryetari po thotë, mos e politizoni, në fakt vetë po e politizon. Ne e kemi trajtuar çështjen e rregullimit të kësaj çështje, qysh shiten, kur shiten, si duhet të shiten, ka rregulluar e udhëzime. Me dijeninë tonë, qeveria e ka pas marrë një vendim. Disa komuna kanë marrë vendim për me

rregulluar këto çështje. Komuna e Prizrenit nuk ka vepruar. Domethënë këtu kemi mosveprim të komunës së Prizrenit, i cili veprim përmes inspektorateve të ndryshme, ndoshta do ta kishte evituar këtë rast ose të paktën do ta kishte hequr përgjegjësinë e komunës së Prizrenit karshi këtij rasti. Në këtë rast, unë personalisht mendoj që nëse banorët ose familjarët që janë dëmtuar, qoftë me fatalitet, qoftë ata që janë dëmtuar financiarisht, për kompenzim të plotë edhe meritë të asaj që atyre i ka ndodhur, duhet me shkuar përmes përgjegjësisë penale të personave që kanë pasur për obligim ligjor, me ndërmarrë veprimet e caktuara që mos me ardhur deri te kjo çështje. Tek, nëse kemi përmes gjykatës një përgjegjësi ligjore penale për personat përgjegjës, tani mund të shkojmë me padi civile në çështje civile ku ata do të merrnin kompenzimin e plotë dhe meritë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit Selman. Fjalën e ka Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Këtu është një çështje, asnjëherë nuk është politizuar kjo çështje për arsye se në këtë tragjedi ta quaj ka humbur një jetë e një njëri. Tjetra nuk është fatkeqësi natyrore, por është fatkeqësi e pakujdesisë dhe neglizhencës së organeve kompetente të komunës. Dhe këtu tash është në pyetje, një rekomandim që u quajt nga kuvendarët që është marrë për kompenzimin e plotë të të gjithë të dëmtuarve dhe që këtë rekomandim mirë që është përpunuar, po në këtë rast personi në fjalë, në këtë vendim Enis Dana, sipas raportit nga Drejtoria e Emergjencave, ai është diku 64.000 euro është i dëmtuar. Dhe këtu me këtë vendim neve ja kompenzojmë vetëm 30.000 euro, që i bjen gjysma. Çka po bëjmë neve me këto? A po i ndihmojmë apo nuk është ndihmë në qoftë se një qytetar i komunës së Prizrenit është dëmtuar 64.000 euro dhe neve me 30.000 euro, kurse të tjerët 100% mbulohen, okay, arsyetimi për shkak shumë më të vogla. Tash është në dilemë edhe secili kuvendar këtu. Edhe unë këtë pyetje po e shtroj tash. Në qoftë se nuk i japim këto 30.000 euro është më keq për atë qytetar. Por ama, cila është garanca nënkryetar, që do të vazhdohet me kërkesën e mëtejshme që të nxirren edhe 30.000 euro të tjera nga ministritë përkatëse. A do të mirret me këtë çështje komuna e Prizrenit? Apo duhet direkt qytetari të mirret me kompenzimin tjetër të prej 34.000 eurove të tjera? Sepse unë me sa e di, neve shumë e përmendi dhe Florenti pak më herët që kemi pasur shumë probleme me kompensime nga dëmet e fatkeqësive natyrore e tjera e tjera nga AME. Por a do të jetë i njëjti fat edhe për këta? Tash unë si kuvendar i këtij i kësaj asambleje, jam në dyshim. Në qoftë se e votoj që qytetari të merr 30.000 euro, a po i bëj dëm apo hajër atij qytetari. Kjo është dilema këtu. Por në qoftë se ju i rrini fjalëve që do ta çoni deri në fund me kërkesën që të kompenzohet, sepse ndryshe është kur një organ si Komuna e Prizrenit i drejtohet AME-së për kompenzime, ndryshe është qytetari vetë nëqoftëse orvatet dhe sorrollatet nëpër korridoret të AME-së atje. Duke i ditur paraprakisht se si kanë vepruar AME-ja. Nëqoftëse e kemi një përgjigje që komuna do t'i rrijë gati kësaj pune dhe që t'ia sigurojë edhe pjesën tjetër nga ministritë përkatëse, atëherë automatikisht unë duhet, mendoj që duhet të mbështetet që t'i ndahen edhe këto.

Bujar Hasani (I pavarur): Unë veç po e shtroj si pyetje se e tha që mos me politizu. Mirëpo ne kemi votuar shumë vendime këtu, edhe na kanë refuzuar pastaj ministria, ministritë përkatëse i kanë, domethënë nuk i kanë përfillur vendimet tona. Andaj, në qoftë se edhe ky votim, edhe ky vendim që merret sot, në qoftë se prapë vjen si i kundërligjshëm, nëse i keni analizuar të gjitha këto, nuk ka problem se nuk duhet të bëhet dilemë tash diskutime, me hyrë në atë punën e komisionit që ka vlerësuar 64 mij apo 50 mij, fundi i fundit secili paguan aq sa ka kapacitetin e

vet, me kapacitet vet paguan. Mirëpo unë kisha dashur një skemë, në qoftë se me të vërtetë vendimin që ne sot do ta votojmë, nuk do të kthehet negativ, unë nuk kam atje. Mirëpo në qoftë se kthehet negativ, mos na futni me votu sepse me të vërtetë po vijnë shumë vendime po na kthehen negative. Faleminderit.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): E para, nuk kthehet vendimi se domethënë është pozicion i caktuar prej të cilët pozicion bëhet kjo pagesë, kjo është ndihmë. Domethënë, ne nuk po paguajmë ndihmë për dëmet që kanë shkaktuar dhe është gjithçka sa i përket pjesës së vendimit. Ndërkohë, pas vendimit për mbulimin e kësaj pjese edhe mbulimin të pjesës tjetër me vendim të kryetarit, raporti në tërësi shkon në qeveri të Republikës së Kosovës, aty ku shqyrtohen të gjitha kërkesat që ndodhen zakonisht prej krejt komunave. Tash, çfarë vendimi merr qeveria? Unë nuke di. Po raporti shkon, besoj, brenda pak ditëve. Edhe do të jetë atje, sepse ky ka qenë i gatshëm për me shku atje. Po ne e kemi stopuar për shkak të këtij vendimi që po e marrim sot. Edhe i njëjti pastaj vazhdon, me njoftimin që palëve ju kanë mbuluar pagesa me këto shumat që sot po i vendosim.

Ramize Shala (D. Emergjencave): Faleminderit kryesuese, unë dashta me ju përgjigjur Florentit. Florenti e di se sa herë në mbledhje unë e kam cilësuar si rast i njëjtë. Tash ta dalloni, se fatkeqësitë natyrore janë fatkeqësitë rrëshqitjet e dheut, zjarret, tërmetet. Ndërsa fatkeqësitë të tjera janë të gjitha fatkeqësitë që mundën me u shkaktuar edhe prej aksidenteve, edhe prej faktorit njeri. Kështu që, pse është bërë ky kompensim? Është bërë për arsye se ju si kuvend keni propozuar kryetarit. Në të kundërtën, kjo kishte me shkuar njëjtë sikurse janë dëmtuar qytetarë të tjerë. Edhe unë qëndroj prapa asaj që e kam thënë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po Florent replik.

Florent Ukaj (LDK): Drejtoreshë ne nuk të pyetëm çfarë fatkeqësie është. Ti qëtu na ke thënë na që nuk kemi të drejtë as si kuvend as si ekzekutiv me marrë vendim për me ju nda mjetet financiare. Na ke thënë nuk kemi fonde, nuk kemi kod buxhetor, qeto ti na ke thënë. Nuk na ke thënë a a për këtë fatkeqësi ose atë fatkeqësi. Ti këtu na ke thënë që nuk na lejon qeveria, kjo edhe akuza te AME-ja, te qeveria. E tash po del krejt e kundërta, që paskam pasur drejtë, por vullneti politik nuk ka qenë. Faleminderit.

Ramize Shala (D. Emergjencave): Është e vërtetë, është e vërtetë, Florent, që kam thënë që ne nuk kemi kod buxhetor për raste emergjente. Edhe është e vërtetë që nuk na ka lejuar qeveria me pasur një fond emergjent. Kjo pagesë është bërë në mënyrë të veçantë, si ndihmë. Prej subvencioneve, nuk është bërë prej një kodi të cilin ne e kemi, sepse nuk kemi kod.

Florent Ukaj (LDK): Pse s'po bëni edhe për të tjerat?

Ramize Shala (D. Emergjencave): Nuk po na lejon qeveria. Ju kam shpjeguar herën e fundit.

Dafina Alishani (LVV): Okej bre, mos e bëni fond, bëni një subvencion për dëme. A s'mundeni me bë? Po jo, kur ka mënyra me shpenzuar paranë diku tjetër, po keni mundësi. Jo bre, jo bre, nënkryetar se s'është në rregull! Singerisht jemi në hall. Se dëmi është i madh. Edhe tash nuk po e dimë as ne çfarë me bë, sepse qytetarët i keni këtu. Ose nëse është mundësia le të dalin edhe ata le të na tregojnë çfarë pritje kanë prej legjislativit, prej ekzekutivit, pse s'ka? Thjesht ne, ne jemi në hall. Ne këtu e kemi pru për rekomandim edhe e kemi sjellë si listë e tanësishme.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dafin, se po duhet me i përsëritur edhe fjalët e nënkryetarit. Është e vërtetë që e kemi votuar si rekomandim. E kemi dërguar me kohë te ekzekutivi, te kryetari. Mundësi t'i tregoj kryetarit çfarë kanë pasur me paguar, por përsëri nënkryetar mere fjalën patjetër.

Kujtim Gashi (Nënkryetar): Jo veç shumë e pata drojen që kemi me rrësqit te politizimi i këtij rasti dhe po e shoh që po do me hy në Dafina qatj. Edhe një kërkesë e kam të sinqertë, miqësore, racionale. Qiten në votim edhe vullneti politik vendoset me votë.

Dafina Alishani (LVV): Mos e politizo çështjen tash, kryesuese a bën veç diçka? Ne jemi këtu persona politikë. Edhe ne rekomandimet i bëmë prej qytetarëve. Çka është kjo drojë, mos e politizoni, mos e politizoni. Pse Kujtim Gashi s'po bën politikë qetu a? Qysh aspak? Politikë, puro politike është çka ka tu bë tash. Pse? Se përgjegjësinë e cila i takon qeverisë lokale po ja gjuan qeverisë qendrore. Puro politike është kjo. Puro politike, ti ti vetë je i pakënaqur prej qeverisë qendrore apo jo? Urdhno, tregoj zotësinë në nivel lokal. A po thuaj që ne jemi të paaftë? Urdhno.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju lutem, Dafina sikurse ti edhe të gjithë ne të tjerët mendoj që kemi pas dëshirë edhe mundësi me u pa... jo mos u drejto ashtu të lutem. Mirëpo këto janë mundësitë që i kemi marrë prej ekzekutivit. Sepse sa për vullnet e për dëshirë kemi pas që 100% me u kompenzu, mirëpo këto janë mundësitë. I kam mbet borxh zotit Muçaj ka disa herë që ka kërkuar fjalën, kërkoj falje dhe të lutem sa më shkurt edhe jemi në proces të votimit.

Agim Muçaj (AAK): Po patjetër, kryesuese. Faleminderit. Pasi shumë koleg këtu me të vërtetë nganjëherë sigurisht edhe marrin edhe orientime politike, por në këto raste të fatkeqësive sigurisht që duhet të mbajmë pak rezerva që mos të politizohen shumë tragjeditë. Unë mendoj që sigurisht se kërkesa e cila është rekomanduar. Kërkesa e cila është rekomanduar për një ndihmë sigurisht se, është e nevojshme jo veç për këtë rast që ka ndodhur kjo tragjedi apo raste të tjera të fatkeqësive, sigurisht se të gjithë ne jemi pro çdo lloj ndihme e cila është e mundur për të bërë, megjithëse ndoshta s'është e duhur ajo që është kërkuar, por sigurisht se jemi pro për atë sa ka mundësi, për atë sa ka mundësi dhe me të vërtetë që të mbajmë pak rezerv në rastet aksidentale, çfarëdo natyrë që ato ndodhin në qytetin tonë dhe dhashë Zotit mos të ndodhin asnjëherë tashë e tutje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Shumë faleminderit zotëri Muça. Jemi në proces të votimit, prezent jemi 27 anëtarë, kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit ditës? Unanimisht. Ju faleminderit të gjithëve. Unë po propozoj me i vazhduar edhe tre pika, i kemi apo po doni pauzë, qysh doni? Qysh jeni shumica ju lutem? Pauzë.

PAS PAUZE

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Prezent jemi vetëm 14 anëtarë dhe nuk mund të vazhdojmë me pjesën tjetër të mbledhjes. Këto pika do të barten në njërën prej seancave tjera. Kështu që shihemi në seancën e radhës, ju faleminderit!



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROPOZIM

Kryetari i Komunës së Prizrenit në bazë nenit 7. paragrafi 3. të Ligjit për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 06/L-092, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 50. shkronja (a), të Statutit të Komunës së Prizrenit, merr këtë:

VENDIM PARAPRAK MBI DHËNIEN E PRONËS KOMUNALE NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit që të merret Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ngastrën kadastrale nr.11048-17 ZK Prizren, Organizatës Shoqërore Civile e cila vepron në territorin e Komunës së Prizrenit, me qëllim të përmbushjes së Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 2

Ngastra kadastrale që do të epet në shfrytëzim, pranë zyrës së kadastrit, është evidentuar si pronë komunale KK Prizren me nr.11048-17, në sipërfaqe prej 1415 m2 ZK Prizren.

Neni 3

Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim organizatës shoqërore civile, konform këtij Vendimi është arsyeshmëria e Interesit të Përgjithshëm Publik në kuadër të kompetencave të komunës, Ndërtimin e objektit “Qendra e Autizmit”, i cili do të zhvillojë aktivitete të veçanta dhe do të ju ofrojë shërbime psiko-sociale dhe aktivitete rekreative për personave me autizëm dhe personave tjerë me nevojë.

Neni 4

Periudha kohore për dhënien e pronës komunale që epet në shfrytëzim është afatshkurtër dhe atë në periudhën prej 15 viteve.

Prona komunale që do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër është në pajtueshmëri me dokumentacionin e planifikimit hapësinor.

Neni 5

Prona Komunale që epet në shfrytëzim afatshkurtër, nuk mund ta ndërron titullarin juridik, pronarin e ngastrës kadastrale mbetet në pronësi të Komunës së Prizrenit dhe si e tillë nuk mund të epet në shfrytëzim personit të tretë nga ana e shfrytëzuesit të zgjedhur si fitues në ankand-nuk mund të tjetërsohet, prona nuk mund të jetë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë komunale.

Neni 6

Komuna e Prizrenit e ruan të drejtën kurdo herë sipas nevojës me qëllim të realizimit të interesave shoqërore apo publike të bëjë ndryshimin e kontratës me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

Neni 7

Procedura e dhënies së Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

Neni 8

Obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunimin me organet tjera komunale si dhe në bashkëpunim me Komisionin Vlerësues të Ofertave për Dhënie të Pronës Komunale në Shfrytëzim, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-092 dhe Rregullores nr.09/2020.


Neni 9

Kryetari Komunës së Prizrenit pas përfundimit të procedurave të tenderimit nga Komisioni Vlerësues, obligohet që të nënshkruajë kontratën mbi shfrytëzimin e pronës komunale në mes të Komunës dhe fituesit të ankandit, ku do të përcaktohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e të dyja palëve.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së këtij vendimi nga ana e MAPL-së.

KRYETARI I KOMUNËS


Shaqir Totaj





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71813068-11048-17

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-05-6797-2025
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	14.04.2025 - 15:28
Komuna / Opština / Municipality:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Prizren / Prizren / Prizren
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71813068-11048-17	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Urban	1415	07-942-05/6797/25	15.01.2025	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PRIZREN			15.01.2025	




A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenje parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/Other Land	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		1415

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH.KK PRIZREN	KCID1832139	PRIZREN / PRIZREN / PRIZREN /		TRG.PRIZREN.LIG	1/1		14.04.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prizren

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71813068-11048-17	Parcelë / Parcela / Parcel	1415



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Enes

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note: _____



Data/ Data/Date: 14.04.2025

Koha/ Vreme/ Time: 03:29:21



PROPOZIM

